

# **MARRËVESHJE BASHKË-PËRGJEGJËSIE SHTOJCË PËR TË PËRBALLUAR SARS - CoV-2 A.S. 2020/2021**

Nisur nga fakti se parakushti për pranimin e studentëve në shkollë është:

- mungesa e simptomave të frymëmarrjes ose e temperaturës së trupit mbi 37.5 ° C edhe tre ditë përpara fillimit të shkollës;
- të mos kenë qenë në karantinë ose izolim shtëpie në 14 ditët e fundit;
- të mos kenë qenë në kontakt me njerëz pozitivë për SARS-CoV-2, për sa janë në dijeni, në 14 ditët e fundit.

Kushdo që ka simptoma të frymëmarrjes ose temperaturë mbi 37.5 ° C do të duhet të qëndrojë në shtëpi. Prandaj, theksohet përgjegjësia individuale e prindërve / kujdestarëve në lidhje me gjendjen shëndetësore të të miturve që u janë besuar atyre.

## **FREKUENTIMI I SHKOLLËS**

Në veçanti, prindi (ose personi me përgjegjësisë prindërore) deklaron se:

- është i vetëdijshëm për masat e parandalimit të sëmundjes ngjitëse, në fuqi deri në datën e sotme;
- fëmija, ose një bashkëjetues i atij vetë brenda familjes nuk i është nënshtruar masës së karantinës ose nuk ka rezultuar pozitiv për SARS - CoV-2;
- do të marr përsipër ta mbajë fëmijën e tij/saj në shtëpi nëse ka temperaturë (mbi 37,5 ° C) e cila do të matet çdo ditë para hyrjes në shkollë, ose në prani të simptomave të tjera që lidhen me SARS - CoV-2 dhe do të informojë menjëherë mjekun pediatër;
- është i vetëdijshëm se duhet të shkojë menjëherë për të marrë fëmijën nëse thirret nga shkolla;
- do të marr përsipër të jetë menjëherë i gatshëm në telefon duke siguruar të gjitha detajet e azhurnuara dhe të nevojshme për kontakt;
- është i vetëdijshëm dhe pranon se në rast temperature mbi 37.5 ° C apo në prani të simptomave të tjera, fëmija i tij / saj nuk do të pranohet në shkollë dhe do të mbetet nën përgjegjësinë e tij / saj;
- është i vetëdijshëm dhe pranon se në rast shfaqjeje të temperaturës (mbi 37.5 ° C) apo simptomave të tjera, nxënësi të shoqërohet në një hapësirë të dedikuar brenda ndërtesës së shkollës deri në momentin e mbërritjes së anëtarëve të familjes, të informuar menjëherë nga stafi i shkollës;
- është i vetëdijshëm se duhet të kontaktojë menjëherë mjekun pediatër për vlerësimin klinik të rastit të fëmijës së tij/saj; nëse ndërmerret një proces

diagnostikues për SARS - CoV-2, mjeku që merr pjesë do të lëshojë një certifikatë për të lejuar ripranimin e nxënësit në shkollë;

- në rastin e fëmijëve të kopshteve, është i vetëdijshëm se do të duhet një certifikatë mjekësore për ripranimin në shkollë pas mungesave prej më shumë se tre ditësh për shkak të sëmundjes;
- është i vetëdijshëm se fëmija i tij/saj do të duhet të respektojë udhëzimet higjieno-sanitare brenda shkollës;
- është i vetëdijshëm se fëmija i tij/saj do të duhet të veshë një maskë kirurgjike kur të hyjë në shkollë nëse është mbi 6 vjeç, përveç rasteve kur kjo përjashtohet;
- do të marrë përsipër të azhurnohet gjithmonë në lidhje me dispozitat në fuqi për kontrollin dhe përballjen e përhapjes së SARS - CoV-2, duke konsultuar gjithashtu edhe uebfaqen institucionale;
- nuk mund të hyjë në shkollë, me përjashtim të situatave të veçanta të dakorduara dhe të autorizuara më parë, gjatë aktiviteteve dhe në prani të fëmijëve;
- është i vetëdijshëm se rreziku i infektimit nuk mund të eliminohet, por do të zvogëlohet në minimum përmes respektimit të përpiktë dhe rigoroz të masave parandaluese dhe të sigurisë, të parashikuara nga protokollet specifike për kryerjen e aktiviteteve (për këtë arsye është e rëndësishme të tregohet kujdes maksimal edhe jashtë kontekstit të institucionit arsimor).

Në veçanti, institucioni arsimor gjatë periudhës së frekuentimit të shkollës:

- merr përsipër të komunikojë çdo ndryshim ose shtesë në dispozita;
- merr përsipër të trajtojë në mënyrë të përshtatshme stafin për të gjitha aspektet që i referohen rregulloreve aktuale për organizimin e shërbimeve shkollore, veçanërisht për procedurat higjieno-sanitare për të luftuar përhapjen e infeksionit.

Vetë personeli:

- merr përsipër të vëzhgojë me përpikëri të gjitha kërkesat higjieno-sanitare dhe të shkojë në punë vetëm në mungesë të simptomave të lidhura me SARS - CoV-2;
- merr përsipër të miratojë të gjitha kërkesat higjieno-sanitare të parashikuara nga legjislacioni aktual, përfshirë dispozitat në lidhje me distancën;
- merr përsipër të respektojë në mënyrë rigorozë dhe me përpikëri, në rast të një infeksioni të konstatuar me SARS - CoV-2 nga një fëmijë ose i rritur që ndjek shkollën, çdo dispozitë nga autoriteti shëndetësor lokal.

## **MATERIALET DHE USHQIMI**

Familjet marrin përsipër t'u sigurojnë fëmijëve të tyre pajisjet e nevojshme për mësimdhënie dhe një zëmër të lehtë, sepse nuk do të lejohet shkëmbimi i materialeve midis nxënësve.

## **TË MËSUARIT NË DISTANCË**

Mësimi në distancë do të aplikohet në rast të një riaktivizimi të virusit SARS - CoV-2, siç përshkruhet me Dekretin Ministror nr. 39 të datës 26/06/2020 - "Plani i Shkollës 2020-2021": paragrafi "Plani i Shkollës për Mësimdhënien e Integruar Digjitale" << Nëse epidemia në vazhdimësi do të shfaq situata të reja emergjence në nivel kombëtar ose lokal, bazuar në masa të menjëhershme ligjore, mund të vendoset pezullimi i mësimit ballë për ballë dhe rifillimi i aktiviteteve në distancë, përmes metodës së integruar të mësimdhënies digjitale. >>

Mësimi në distancë kërkon një ripërcaktim dhe forcim të marrëveshjes arsimore të bashkë-përgjegjësive midis shkollës dhe familjeve duke iu referuar qarkoreve të lëshuara dhe shpërndara nga IC (Institutit Gjithëpërfshirës – Istituto Comprensivo).

Shkolla merr përsipër të:

- vërë në dispozicion për përdorim pajisjet që ajo disponon dhe të kryejë mësimin në distancë përmes aplikacioneve të mbështetura edhe nga celularët, të vetëdijshëm se jo të gjitha familjet kanë pajisje të njëjta teknologjike, në lidhje edhe me numrin e fëmijëve të moshës shkollore;
- rikalibrojë dhe komunikojë përmes Regjistrit Elektronik (RE) dhe / ose faqes në internet, objektivat e planifikimit vjetor dhe kriteret e vlerësimit;
- bëjë zgjedhje didaktike fleksibël që marrin parasysh situatat e ndryshme familjare dhe individuale, veçanërisht në rastin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- veprojë në një fashë të caktuar kohore, në mënyrë që të ndihmojë nxënësit dhe familjet të ndajnë kohën e punës nga familja;
- mbajë komunikimin me familjet, individualisht dhe kolektivisht, përmes kanaleve të internetit të përdorura zakonisht dhe në veçanti përmes faqes në internet dhe RE (regjistrit elektronik).

Familja merr përsipër të:

- konsultohet periodikisht me RE-në dhe faqen e internetit të institutit arsimor për të parë komunikimet e shkolles;
- stimulojë nxënësin të marrë pjesë në mënyrë sa më të pavarur dhe të përgjegjshme në aktivitetet e mësimit në distancë dhe të kryejë detyrat e caktuara duke respektuar afatet;
- sigurohet që përmbajtja e mësimeve, regjistrimet e tyre të mundshme dhe materiali në internet që është postuar për përdorim arsimor të mos përdoret në mënyrë të papërshtatshme;
- kontrollojë respektimin e të gjitha rregulloreve aktuale për mbrojtjen e privatësisë.

# MARRËVESHJE BASHKË-PËRGJEGJËSIE SHTOJCË PËR TË PËRBALLUAR SARS - CoV-2 A.S. 2020/2021

Të plotësohet dhe të kthehet e firmosur

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_ ), më datë  
\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_ ), me adresë:  
\_\_\_\_\_;

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_ ), më datë  
\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_ ), me adresë:  
\_\_\_\_\_;

Bartësi/e (Titullar) / (Titullare) i/e përgjegjësishë prindërore të nxënësit/es \_\_\_\_\_ që  
frekuenton klasën \_\_\_\_\_ seksioni \_\_\_\_\_ të kopshtit/shkollës fillore/të mesme të  
ulët \_\_\_\_\_ (I.C. "P. Straneo")

## DEKLAROJMË

se kemi lexuar marrëveshjen e bashkëpërgjegjësishë dhe shtojcën e saj për të përballuar COVID-19 midis Institutit  
Gjithëpërfshirës "P. Straneo", familjes dhe nxënësit përmes:

faqes në internet ([www.straneo.it](http://www.straneo.it))

Regjistrin Elektronik

dokumentit të disponueshëm të postuar në komplekset e ndryshme të Institutit Gjithëpërfshirës

dhe komunikojmë numrat e azhurnuar dhe gjithmonë të arritshëm të telefonit në mënyrë që të lejojmë kontakt të  
menjëhershëm me familjen ose personin e besuar në rast nevojë

numri ..... numri .....

numri ..... numri .....

adresë e mundshme e-mail .....

Alessandria, \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i të dy prindërve ose kushdo që zë vendin e tyre

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Drejtori i shkollës

**Prof. Raffaella Norese**

(Nënshkrimi i shkruar me dorë zëvendësohet me shtyp  
ish arti 3, paragrafi 2 i Dekretit Legjislativ 39/93)